



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Nr. 1013/3 prot

Tiranë më 18/7 /2014

REKOMANDIM

Nr 63, datë 18/7/2014

Mbështetur në ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr 211, datë 11.09.2008 "*Për zgjedhjen e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" dhe nr. 225, datë 13.11.2008 "*Për miratimin e strukturës organike dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Hetim-Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit "*Bosnalijek d.d*".

KONSTATOVA

Në zbatim të Urdhrit nr. 92 datë 29.05.2014, të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, është kryer inspektimi administrativ pranë kontrolluesit "*Bosnalijek d.d*". me objekt:

- "*Zbatimi nga ana e kontrolluesit i ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, si dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, gjatë kryerjes së aktivitetit të tij*".

"*Bosnalijek d.d*" në kuptim të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, është kontrollues privat me objekt të aktivitetit të tij veprimtarinë në fushën e marketingut të produkteve dhe medikamenteve farmaceutike. Në kuadër të kryerjes së veprimtarisë përpunon të dhëna personale për kategoritë "*punonjës*" dhe "*klientë*" si: *emër, mbiemër, gjinia, mosha, datëlindja, vendlindja, atësia, gjendja penale, adresa e banimit, numër i sigurimit shoqëror, numri personal i identifikimit, foto, numri i telefonit fiks ose celular, e-mail, të dhëna shëndetësore.*

Të dhënat personale të "*klientëve*" mblidhen gjatë prezantimit të medikamenteve farmaceutike të kompanisë prodhuese e cila e ka selinë në Sarajevë (Bosnje Hercegovinë). Kontrolluesi kryen vetëm marketingun, jo shitjen, të dhënat mbahen në kompjuter dhe aksesit është i kufizuar dhe i siguruar nëpërmjet fjalëkalimit përkatës.

Nga ana e subjektit tuaj nuk është realizuar detyrimi për njoftim pranë Autoritetit të Komisionerit, në zbatim të nenit 21 të ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar. Në njoftim duhet të deklaroni nëse përpunimi i të dhënave bëhet për një qëllim apo për disa qëllime, një përskrim i përgjithshëm i masave për sigurinë e të dhënave personale, nëse janë hartuar, miratuar dhe zbatohen rregulla konkrete të cilat bëjnë të mundur përpunimin e sigurtë dhe të ligjshëm të të dhënave personale.



Rëndësi të veçantë ka caktimi i një oficeri (*ose personi të ngarkuar*) sipas nenit 3/14 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, për mbrojtjen e të dhënave nga kontrolluesit, si dhe regjistrimi i tij pranë KMDP, pasi shton besimin dhe transparencën e procesit të përpunimit të të dhënave personale.

Nuk janë konstatuar praktika për të informuar " *klientët*" dhe " *punonjësit*" për fushën dhe qëllimin për të cilin do të përpunohen të dhënat personale, për mënyrën e përpunimit, për të drejtën për akses, si dhe të drejtën për korrigjim të të dhënave të tyre në zbatim të nenit 18 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar.

Informacioni duhet të jepet i saktë dhe sa më shpejtë që të jetë e mundur ku të përfshihen mënyrat e përpunimit të të dhënave personale, masat e sigurisë, ruajtja e konfidencialitetit, të drejtat e subjekteve të të dhënave dhe detyrimet e kontrolluesit në kuadër të mbrojtjes së privatësisë.

Subjekti juaj nuk ka hartuar rregulla lidhur me mbledhjen, përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave personale, prandaj në zbatim të neneve 27, 28 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar, keni detyrimin të hartoni rregullore të brendshme lidhur me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen, sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave personale. Hartimi i rregullave është një siguri më shumë për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të subjekteve të të dhënave, gjatë përpunimit të të dhënave personale që kryeni ju si kontrollues.

Sa më sipër;

Në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, si dhe nenet 107-109 të K. Pr. Administrative :

## REKOMANDOJ

1. Në zbatim të nenit 18 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, të merren masa me qëllim informimin e subjekteve të të dhënave personale, si dhe të përfshihen kushtet e kriteret që reflektojnë parimet e përpunimit të ligjshëm dhe të drejtë të të dhënave personale.
2. Në zbatim të nenit 21 të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave personale*" i ndryshuar, të realizohet detyrimi për njoftim pranë Autoritetit së Komisionerit, për përpunimin e të dhënave personale nga ju si kontrollues. Informacione të rëndësishme lidhur me njoftimin mund të gjeni në faqen zyrtare të Komisionerit [www.kmdp.al](http://www.kmdp.al), si dhe ofrojmë asistencën tonë.
3. Në zbatim të neneve 27 dhe 28 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, të hartohet rregullore e brendshme lidhur me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen, sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave personale. Rregulloren tip mund ta gjeni në faqen zyrtare të Komisionerit [www.kmdp.al](http://www.kmdp.al), si dhe ofrojmë asistencën tonë.
4. Kryerja e këtyre detyrimeve të rëndësishme të realizohet brenda një afati kohor prej 45 (*dyzet e pesë*) ditësh, nga momenti i marrjes dijeni të këtij Rekomandimi.

5. Për plotësimin e këtyre detyrimeve të njoftohet me shkrim pranë Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

6. Me kalimin e këtij afati në rast mospërbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, sipas të cilit.. "Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të rekomandimeve të tij, vepron sipas nenit 39 të këtij ligji dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave".

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

